



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

Legjislatura VI  
Sesioni pranveror

Seanca plenare e Kuvendit  
SP-024  
Prishtinë, më 16, 23 dhe 30 mars 2018

**PROCESVERBAL**

**I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,  
E MBAJTUR MË 16, 23 DHE 30 MARS 2018**

Seancën e kryesoi Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit, i ndihmuar nga Xhavit Haliti dhe Kujtim Shala, nënkryetarë të Kuvendit.

Kryetari i hapi punimet e seancës plenare, sipas rendit të ditës të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 9 mars 2018.

**1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës**

Deklarime jashtë rendit të ditës paraqitën këta deputetë: Bekim Haxhiu, Lumir Abdixhiku, Arbërie Nagavci, Teuta Haxhiu, Frashër Krasniqi, nënkryetari i Kuvendit, z. Kujtim Shala, Milaim Zeka, nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti, Emilija Rexhepi, Dardan Molliqaj, Ganimete Musliu, Adem Mikullovc, Salih Salihu, Avdullah Hoti, Sami Kurteshi, Lirije Kajtazi, Valentina Bunjaku-Rexhepi, Naser Rugova, Armend Zemaj, Haxhi Avdyli, Elmi Reçica, Lutfi Zharku dhe Salih Zyba, si dhe kryeministri i Kosovës, z. Ramush Haradinaj dhe z. Abelard Tahiri, ministër i Drejtësisë, Uran Ismaili, ministër i Shëndetësisë dhe Pal Lekaj, ministër i Infrastrukturës, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

## **2. Koha për pyetje parlamentare**

Deputetja Arbërie Nagavci i parashtrroi pyetje kryeministrit të Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, në lidhje me mbajtjen e një minutë heshtjeje në mbledhjen e Qeverisë së Kosovës, të mbajtur më 22 janar 2018, për vrasjen e Oliver Ivanoviqit dhe të vdekjes së veprimtarit Jonuz Musliu.

Kryeministri Ramush Haradinaj iu përgjigj pyetjes së deputetes.

Deputetja Arbërie Nagavci i parashtrroi pyetje ministrit të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, në lidhje me funksionimin dhe ndarjen e buxhetit për Gjimnazin e specializuar Matematikor në Prishtinë.

Ministri Shyqiri Bytyqi iu përgjigj pyetjes së deputetes.

Deputeti Ismajl Kurteshi i parashtrroi pyetje ministrit të Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica, në lidhje me pensionin kontributpagues për qytetarët që nuk i kanë 15 vjet stazh pune deri në vitin 1999.

Ministri Skender Reçica iu përgjigj pyetjes së deputetit.

Deputeti Ismajl Kurteshi i parashtrroi pyetje ministrit të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, në lidhje me masat e ndërmarra nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për ndaljen e regjistrimit të studentëve në kolegjet private pas afatit zyrtar të regjistrimit.

Ministri Shyqiri Bytyqi iu përgjigj pyetjes së deputetit.

Deputetja Ganimete Musliu i parashtrroi pyetje ministrit të Shëndetësisë, Uran Ismaili, në lidhje me nivelin e zbatimit të Ligjit për duhanin.

Ministri Uran Ismaili iu përgjigj pyetjes së deputetes.

Deputetja Time Kadrijaj i parashtrroi pyetje ministrit të Shëndetësisë, Uran Ismaili, në lidhje me licencimin e dy gjeneratave të diplomuara në Fakultetin për Biokimi-Fiziologji.

Ministri Uran Ismaili iu përgjigj pyetjes së deputetes.

Deputeti Xhelal Sveçla i parashtrroi pyetje kryeministrit të Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, në lidhje me përgatitjet e Qeverisë për zbatimin e 12 marrëveshjeve të nënshkruara më 27 nëntor 2017 ndërmjet Qeverisë së Kosovës dhe Qeverisë së Shqipërisë dhe dërgimin e tyre për informim në Kuvendin e Kosovës.

Kryeministri Ramush Haradinaj iu përgjigj pyetjes së deputetit.

Deputetja Fitore Pacolli-Dalipi i parashtrroi pyetje kryeministrit të Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, në lidhje me çështjen se cilat koordinata të vijës kufitare me Malin e Zi i njeh Qeveria aktuale e Kosovës, ato të marrëveshjes së përgatitur nga Komisioni i drejtuar nga z. Murat Meha, apo ato të cilat janë paraqitur me argumente dhe vërejtje nga raporti i Komisionit shtetëror, i drejtuar nga z. Shpëtim Bulliqi.

Kryeministri Ramush Haradinaj iu përgjigj pyetjes së deputetes.

Deputetja Besa Baftiu i parashtrroi pyetje ministrit të Shëndetësisë, Uran Ismaili, në lidhje me mungesën e insulinës për pacientët me sëmundjen e diabetit. Ministri Uran Ismaili iu përgjigj pyetjes së deputetes.

Deputeti Imet Rrahmani i parashtrroi pyetje kryeministrit të Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, në lidhje me planet e kryeministrit për zgjidhjen e çështjes së pajisjes me nënshtetësi të Kosovës të shqiptarëve nga komunat e Bujanocit, Preshevës dhe Medvegjës, të cilët jetojnë Kosovë. Kryeministri Ramush Haradinaj iu përgjigj pyetjes së deputetit.

Deputetja Shqipe Pantina i parashtrroi pyetje kryeministrit të Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, në lidhje me planet e kryeministrit për adresimin e praktikave të institucioneve qeveritare të organizimit të punëtorive jashtë Kosovës për hartim të dokumenteve publike. Kryeministri Ramush Haradinaj iu përgjigj pyetjes së deputetes.

### **3. Interpelanca e kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Ramush Haradinaj, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje lidhur me vdekjen e dhunshme të aktivistit të Lëvizjes Vetëvendosje, Astrit Dehari**

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje ka parashtruar kërkesë për ta ftuar në interpelancë kryeministrin Ramush Haradinaj lidhur me vdekjen e dhunshme të aktivistit të Lëvizjes Vetëvendosje, Astrit Dehari.

Ai i njoftoi deputetët për kohëzgjatjen e interpelancës prej tri orësh, si dhe për kohën e ndarë për secilin grup parlamentar dhe për deputetët pa grup parlamentar.

Kryesuesi e ftoi propozuesin e interpelancës që ta marrë fjalën.

Në emër të Grupit Parlamentar të LVV-së, Albin Kurti tha se më 29 gusht të vitit 2016, vetëm dy ditë para protestës së 1 shtatorit kundër “demarkacionit” të kufirit me Malin e Zi, e cila do të mbahej në ditën kur Qeveria e atëhershme kishte paralajmëruar ratifikimin e atij “demarkacioni”, u arrestuan gjashtë aktivistë të Lëvizjes Vetëvendosje, në mesin e të cilëve edhe Astrit Dehari.

Më pas ai tha se dy muaj më vonë vjen lajmi i kobshëm se Astriti ka vdekur. Komandanti i Policisë i rajonit të Prizrenit, Nexhmi Krasniqi, pak orë pasi vdiq Astrit Dehari, ishte i pari zyrtar i shtetit që foli, thua se Astriti vdiq në stacion të policisë, e jo në burg. Për 68 ditë në burg Astriti nuk u mor në pyetje fare. Prokuroria nuk e merrte në dorë Astritin, disi ia kishte lënë policisë, ani se po e mbante në burg.

Pastaj, z. Kurti vazhdoi se Kryeprokurori i Gjykatës Themelore në Prizren, Sylë Hoxha, menjëherë konstatoi se Astriti ishte vetëvrarë ende pa u bërë e pa u kryer hetimet. Njësoj, edhe prokurori i rastit në Prokurorinë Themelore në Prizren, Metush Biraj, pa u mbyllur

hetimet e udhëhequra nga ai, deklaroi se Astriti është vetëvrarë. Synimi i tyre ishte i qartë: të mbyllen hetimet sa më parë që praktikisht do të thotë të mos bëhen fare ato. Askush deri më tani nuk ka dhënë përgjegjësi për deklaratat e rreme.

Deputeti Albin Kurti vijoi se vetëm 3 ditë pas vdekjes së Astritit, në Televizionin Klan dhe nga gazeta “Express” u emetuan skena nga video incizimet e bëra nga video kamerat e instaluar në Qendrën e Paraburgimit në Prizren, megjithëse detyrimi ligjor për ruajtjen e këtyre incizimeve si material sensitiv për hetim është dashur të respektohet. Si doli jashtë ky material? Pse mu të këto dy medie, kur publikisht dihet qëndrimi redaksional e politik i tyre kundër Lëvizjes sonë?

Ai shtoi se një hetimi i pavarur ndërkombëtar që e rifillon shqyrtimin është i domosdoshëm. Për paaftësinë e mjekëve të Mjekësisë Ligjore flet edhe Raporti i fundit i Progresit i Komisioni Evropian për Kosovën nga viti 2016, i cili në faqe 21 thotë: “Agjencia e Kosovës për Forenzikë dhe laboratorët e saj kanë pajisje teknike të mjaftueshme për kryerjen e analizave përkatëse të Mjekësisë Ligjore. Staf i agjencisë ka nevojë për trajnim rreth shërbimit dhe për ndihmë nga EULEX-i. Aftësia e saj për të ofruar patologjinë e duhur mjeko-ligjore mbetet shumë e dobët. Duhet të sigurohet financimi i vazhdueshëm i agjencisë”.

Më 8 shkurt 2018 avokati i familjes e ka pranuar vendimin e Prokurorisë në Prizren për lejimin e hetimit të pavarur nga Instituti Zvicëran i Mjekësisë Ligjore, sipas kërkesës së familjes Dehari.

Në fund z. Kurti e paraqiti tekstin e mocionit trepikësh për interpelancën. Diskutimi i plotë i z. Albin Kurti është dhënë në transkript.

Kryetari e ftoi kryeministrin e Kosovës që ta paraqesë qëndrimin e Qeverisë lidhur me këtë çështje.

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, tha se është e vërtetë që kjo ngjarje i ka prekur zemrat dhe ndjenjat e të gjithë njerëzve, jo veç të Kosovës, por të gjithë atyre që kanë dëgjuar atë kohë për vdekjen e Astrit Deharit. Tragjedia bëhet më e madhe, meqë është i dyti i familjes, po ashtu ngjarje tragjike dhe është një tragjedi që ka plot implikime ose plot dimensione dhe implikon e nxit një diskutim. Unë i kam njohur prindërit e Astritit, i kam takuar në Lëvizjen Popullore për Republikën e Kosovës. Kanë qenë në krahun më luftarak dhe kjo familje, si shumë të tjera, kanë dhënë gjithçka për lirinë e Kosovës.

Shpenzimet e parapara për hetim i mbulon Qeveria.

Problemi tjetër që e kemi dhe që unë e pranoj këtu, thotë kryeministri, edhe publikisht, para të gjithë juve, është se në sistemin korrektues kemi disa defekte. Janë disa vakume që duhet pasur kujdes, janë disa probleme që janë shfaqur dhe është shumë me rëndësi që t’ia vëmë vëmendjen në nivel nacional. Po shpresoj që gradualisht do të mund ta sjellim punën që

sistemi korrektues të mund t'i ndihmojë qytetarët e Kosovës që kalojnë nëpër sanksione ligjore që t'i kthehen jetës, t'i kthehen vendit, t'i kthehen shoqërisë, mundësisht sa më të përgatitur për jetën më tutje, edhe jashtë veprave që i kanë kaluar. Mirëpo, aktualisht në sistemin korrektues ka disa vështirësi. Janë disa defekte, jemi në proces për ta zgjedhur një drejtor të burgjeve të Kosovës.

Është me rëndësi që t'i respektojmë pushtetet e ndara. Unë e përfaqësoj ekzekutivin dhe i raportoј Kuvendit. Po ashtu, i kisha lutur edhe deputetët që në diskutimet e tyre ta respektojnë raportin ndërmjet Kuvendit dhe gjyqësorit.

Rekomandimet e Kuvendit e obligojnë Qeverinë e Kosovës që ta zbardhë çdo aspekt të kësaj ngjarjeje të dhimbshme, si në mbulimin e shpenzimeve për cilindo institucion që përcaktohet familja. Diskutimi i plotë i kryeministrit është dhënë në transkript.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin për interpelancën e kryeministrit Ramush Haradinaj.

Për interpelancën e kryeministrit diskutuan deputetët: Armend Zemaj, në emër të GP të LDK-së; Memli Krasniqi, në emër të GP të PDK-së; Glauk Konjufca, në emër të GP të LVV-së; Visar Ymeri, në emër të GP Deputetët e Pavarur; Ahmet Isufi, në emër të GP të AAK-së; Bilall Sherifi në emër të GP të NISMA-s, Besa Gaxherri, Safete Hadërgjonaj; kryetari i Kuvendit, Kadri Veseli, Albulena Haxhiu, Hajdar Beqa, Arbërie Nagavci, Sami Kurteshi, Frashër Krasniqi, Arbër Rexhaj, si dhe kryeministri Ramush Haradinaj, Abelard Tahiri, ministër i Drejtësisë dhe Dhurata Hoxhaj, ministre e Integriteteve Evropiane, diskutimet e të cilëve të plota janë dhënë në transkript.

Në fund, kryeministri Ramush Haradinaj dha sqarime shtesë lidhur me debatin e zhvilluar.

Pas këtyre diskutimeve, Albin Kurti, në emër të propozuesit të interpelancës, dha sqarime shtesë lidhur me debatin e zhvilluar.

Kryetari e hodhi në votim miratimin e tekstit të mocionit të propozuar, mirëpo nuk pati kuorum të mjaftueshëm për vendimmarrje.

Kryetari, në mungesë kuorumit të mjaftueshëm për vendimmarrje, i ndërpreu punimet e seancës plenare në orën 18:20.

\* \* \*

*E premte, më 23 mars*

*Vazhdimi i mbledhjes plenare, e filluar më 16 mars 2018*

Kryetari procedoi me pikat e papërfunduara, si në vijim:

### **3. Votimi i rekomandimeve nga interpelanca e kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Ramush Haradinaj, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje lidhur me vdekjen e dhunshme të aktivistit të Lëvizjes Vetëvendosje, Astrit Dehari**

Në fillim të seancës, kryetari i GP të LVV-së, Glauk Konjufca, propozoi që votimi për këtë pikë të shtyhet, me arsyetimin se disa deputetë të këtij grupi parlamentar gjenden në ndalim (arrest).

Kryetari kërkoi deklarinimin e kryetarëve e grupeve parlamentare lidhur me kërkesën e paraqitur nga kryetari i GP të LVV-së, z. Konjufca.

Lidhur me kërkesën e lartshënuar diskutuan deputetët: Avdullah Hoti, në emër të GP të LDK-së; Memli Krasniqi, në emër të GP të PDK-së; Dardan Sejdiu, në emër të GP të Deputetëve të Pavarur; Ahmet Isufi, në emër të GP të AAK-së; Bilall Sherifi, në emër të GP NISMA dhe Albert Kinolli në emër të GP “6+”, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas diskutimeve, Kuvendi vendosi që votimi i rekomandimeve nga interpelanca e kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Ramush Haradinaj, të shtyhet për seancën e radhës.

### **4. Shqyrtimi i Propozim-Programit të punës së Kuvendit të Kosovës për vitin 2018**

Kryetari i njoftoi deputetët lidhur me proceduat e përgatitje së Programit të punës së Kuvendit për vitin 2018.

Ai e hapi debatin lidhur me Propozim-Programin e punës së Kuvendit të Kosovës për vitin 2018.

Për Programin e punës së Kuvendit të Kosovës për vitin 2018 diskutuan deputetët: Sala Berisha-Shala, në emër të Komisionit për Zhvillim Ekonomik; Albulena Haxhiu, në emër të Komisionit për Legjislacion; Armend Zemaj, në emër të GP të LDK-së; Zenun Pajaziti, në emër të GP të PDK-së; Glauk Konjufca, në emër të GP të Lëvizjes Vetëvendosje; Shqipe Pantina, në emër të GP të Deputetëve të Pavarur; Ahmet Isufi, në emër të GP të AAK-së; Zafir Berisha, në emër të GP NISMA; Albert Kinolli, në emër të GP “6+”; Blerta Deliu-Kodra, Time Kadrijaj, Milaim Zeka, Bekim Haxhiu, Ismajl Kurteshi, Teuta Haxhiu, Xhevahire Izmaku, Sami Kurteshi, Flora Brovina dhe Shkumbin Demaliaj, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pastaj kryetari e hodhi në votim Propozim-Programin e punës së Kuvendit të Kosovës për vitin 2018.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 65,  
Kundër ----- 0,  
Abstenime ----- 3.

Kuvendi mori këtë:

## V E N D I M

Miratohet Programi i punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës për vitin 2018.

\* \* \*

Në vazhdim, kryetari i Komisionit Funkcional për Buxhet dhe Financa, Lumir Abdixhiku, propozoi që me shmangie nga Rregullorja e Kuvendit, Kuvendi në seancën e sotme ta radhisë në rend dite edhe shqyrtimin e dytët të Projektligjit nr. 06/L-023 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-115 dhe me Ligjin nr. 05/L-080.

Kryetari e hodhi në votim propozimin e z. Abdixhiku.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 46,  
Kundër ----- 11,  
Abstenime ----- 12.

Kuvendi me shumicë votash vendosi që shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 06/L-023 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-115 dhe me Ligjin nr. 05/L-080, të renditet si pikë e fundit e rendit të ditës së kësaj seance.

### **5. Shqyrtimi i parë i Projekt-Rregullores së Kuvendit**

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar këtë Projekt-rregullore dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e saj.

Kryetarja e Komisionit Funkcional për Legjislacion, Albulena Haxhiu, e paraqiti dhe e arsyetoi raportin e Komisionit Funkcional.

Lidhur me Projekt-Rregulloren e Kuvendit diskutuan deputetët: Arben Gashi, në emër të GP të LDK-së; Hajdar Beqa, në emër të GP të PDK-së; Albulena Haxhiu, në emër të GP të Lëvizjes Vetëvendosje; Dardan Sejdiu, në emër të GP të Deputetëve të Pavarur; Shkumbin

Demaliaj, në emër të GP të AAK-së; Igor Simiq, në emër të GP Lista serbe; Bilall Sherifi, në emër të GP NISMA; Bahrim Shabani, në emër të GP “6+”; Sami Kurteshi, Armend Zemaj, Emilija Rexhepi, Sala Berisha-Shala, Teuta Haxhiu, Milaim Zeka, Naser Rugova, Blerim Kuçi, Ilir Deda, Adem Mikullovc, Bekim Haxhiu dhe Kujtim Shala, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryetari tha se në mungesë të kuorumit të mjaftueshëm për vendimmarrje, procedimi i votimit në parim i Projekt-Rregullores shtyhet.

## **6. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes për hua ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për projektin e autostradës Kijevë-Zahaq**

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni FunkSIONAL për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij.

Pastaj, kryetari e ftoi ministrin e Financave ta paraqesë dhe ta arsyetojë projektligjin.

Ministri i Financave, Bedri Hamza, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi në tërësi përmbajtjen dhe strukturën e projektligjit si dhe i ftoi deputetët që ta miratojnë.

Lidhur me Projektligjin për ratifikimin e marrëveshjes për hua ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për projektin e autostradës Kijevë-Zahaq, diskutuan: Lumir Abdixhiku, në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa; Lutfi Zharku, në emër të GP të LDK-së; Safete Hadërgjonaj, në emër të GP të PDK-së; Albulena Haxhiu, në emër të GP të Lëvizjes Vetëvendosje; Dardan Sejdiu në emër të GP të Deputetëve të Pavarur; Blerim Kuçi, në emër të GP të AAK-së; Enver Hoti, në emër të GP NISMA, Arben Gashi, Time Kadrijaj, Rexhep Selimi, Milaim Zeka, Bilall Sherifi, Albin Kurti, Armend Zemaj, Dardan Sejdiu, Naser Rugova, Islam Pacolli, Shqipe Pantina, Veton Berisha, kryeministri Ramush Haradinaj dhe ministri Bedri Hamza, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kryetari tha se në mungesë të kuorumit të mjaftueshëm për vendimmarrje, procedimi i votimit të këtij projektligji shtyhet.

\* \* \*

Në vazhdim, kryetarja e Komisionit FunkSIONAL për Integritime Evropiane, Blerta Deliu-Kodra, propozoi që shqyrtimi i dytë i projektligjeve të parapara me Agjendën për Reformë Evropiane (ERA) dhe Raportin për vendin, të bëhet me procedurë të përshpejtuar, me shmangie nga afatet procedurale të parapara me Rregulloren e Kuvendit.

Kryetari e hodhi në votim propozimin e kryetares së Komisionit për Integritime Evropiane, znj. Deliu.



Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 66,  
Kundër ----- 1,  
Abstenime ----- 0.

Kuvendi mori këtë:

## V E N D I M

1. Shqyrtimi dhe miratimi i projektligjeve të parapara me Agjendën për Reformë Evropiane (ERA) dhe Raportin për vendin, të cilat duhet të miratohen deri më 31 mars 2018, të bëhet me procedurë të përsheptuar, shmangie nga afatet procedurale të parapara me nenin 15, paragrafi 7, neni 57, paragrafët 3, 8 dhe 9 dhe neni 64, paragrafi 4 të Rregullores së Kuvendit, si në vijim:

1.1. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 06/L-032 për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim bëhet në seancën plenare më 23 mars 2018.

1.2. Shqyrtimi i dytë i projektligjeve: 1. Projektligji nr. 06/L-011 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik; 2. Projektligji nr. 06/L-025 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-225 për Prokurorin e Shtetit, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 05/L-034; 3. Projektligji nr. 06/L-021 mbi kontrollin e brendshëm të financave publike; 4. Projektligji nr. 06/L-026 për azil; 5. Projektligji nr. 06/L-036 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-219 për të huajt; 6. Projektligji nr. 06/L-029 mbi mbrojtjen nga rrezatimi dhe sigurinë bërthamore; 7. Projektligji nr. 06/L-032 për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim; 8. Projektligji nr. 06/L-037 për metrologji dhe 9. Projektligji 06/L-041 për kërkesat teknike për produkte dhe vlerësim të konformitetit, bëhet në seancën e veçantë plenare, më 30 mars 2018, ora 14:00.

1.3. Amendamentet në projektligjin nga pika 1.1. e këtij vendimi, në Projektligjin nr. 06/L-037 për metrologji dhe në Projektligjin nr. 06/L-041 për kërkesat teknike për produkte dhe vlerësim të konformitetit mund t'u adresohen komisioneve funksionale deri më 27 mars 2018.

1.4. Komisionet funksionale projektligjet nga pika 1.2. e këtij vendimi deri më 28 mars 2018 duhet t'i shqyrtojnë projektligjet dhe raportet me rekomandime t'ua paraqesin komisioneve të përhershme.

1.5. Komisionet e përhershme deri më 29 mars 2018 duhet t'i shqyrtojnë projektligjet dhe raportet me rekomandime t'ua paraqesin komisioneve funksionale.

1.6. Komisionet funksionale deri më 30 mars 2018 duhet t'i paraqesin raportet me rekomandime për shqyrtim të dytë në seancë plenare.

Në vazhdim, kryetari procedoi me pikën e rendit të ditës, sipas vendimit të shënuar më lart.

## **1. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 06/L-032 për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim**

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni FunkSIONAL për Mbikëqyrjen e Financave Publike e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij.

Ai e ftoi ministrin e Financave ta paraqesë dhe ta arsyetojë projektligjin.

Ministri i Financave, Bedri Hamza, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi në tërësi përmbajtjen dhe strukturën e projektligjit. Ai i ftoi deputetët që ta miratojnë këtë projektligj.

Lidhur me Projektligjit nr. 06/L-032 për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim diskutuan: Driton Selmanaj, në emër të Komisionit FunkSIONAL për Mbikëqyrjen e Financave Publike; Lutfi Zharku, në emër të GP të LDK-së; Shqipe Pantina në emër të GP Deputetët e Pavarur; Arben Gashi dhe ministri Valdrin Lluka, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pastaj, kryetari e hodhi në votim Projektligjin nr. 06/L-032 për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 66,  
Kundër ----- 1,  
Abstenime ----- 0.

Kuvendi mori këtë:

### **V E N D I M**

Miratohet në parim Projektligji nr. 06/L-032 për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim.

Ngarkohen Komisioni FunkSIONAL dhe komisionet e përhershme që projektligjin ta shqyrtojnë në afatin e paraparë me vendimin e Kuvendit të datës 23 mars 2018 dhe Kuvendit t'i paraqesin raportet me rekomandime.

Pastaj, kryetari procedoi edhe pikat e tjera të rendit të ditës:

## **11. Shqyrtimi i raportit të performansës së ndërmarrjeve publike për vitet 2015 dhe 2016**

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik e ka shqyrtuar këtë raport dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij.

Në vazhdim ai e ftoi ministrin e Zhvillimit Ekonomik ta paraqesë raportin.

Ministri i e Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka, e paraqiti përmbajtjen e raportit si dhe i ftoi deputetët që ta miratojnë këtë raport.

Lidhur me raportin e performansës së ndërmarrjeve publike për vitet 2015 dhe 2016 diskutuan: Bilall Sherifi në emër të Komisionit FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik; Hykmete Bajrami, në emër të GP të LDK-së; Memli Krasniqi, në emër të GP të PDK-së; Albin Kurti, në emër të GP të LVV-së; Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit, Lutfi Zharku, Shqipe Pantina, Arben Gashi, Sami Kurteshi, Korab Sejdiu, Albulena Haxhiu, Mimoza Kusari-Lila, Sala Berisha-Shala, Lumir Abdixhiku, Memli Krasniqi, Bedri Hamza, ministër dhe ministri Valdrin Lluka, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kryetari, për mungesë të kuorumit, i ndërpreu punimet e seancës plenare në orën 19:55.

Ai konstatoi se seanca i vazhdon punimet me pikat e papërfunduara të premtën, më 30 mars 2018, në orën 10:00, ndërsa seanca tjetër i fillon punimet në orën 14:00, me shqyrtimin e dytë të projektligjeve që kanë të bëjnë me Agjendën për Reformë Evropiane (ERA) dhe Raportin për vendin.

\* \* \*

*E premte, më 30 mars*

*Vazhdimi i mbledhjes plenare*

Në fillim, kryetari ua dha fjalën deputetëve të paraqitur për të diskutuar lidhur me ndodhitë gjatë javës. Diskutuan këta deputetë: Avdullah Hoti, në emër të GP të LDK-së; Memli Krasniqi, në emër të GP të PDK-së; Glauk Konjufca, në emër të GP të LVV-së; Dardan Molliqaj, në emër të GP të Deputetëve të Pavarur; Ahmet Isufi, në emër të GP të AAK-së; Sasha Milosavljeviq, në emër të GP Lista serbe; Bilall Sherifi, në emër të GP NISMA; Myfera Srbica-Shinik, në emër të GP “6+”, kryeministri Ramush Haradinaj, kryetari Kadri Veseli, nënkryetari Kujtim Shala, Armend Zemaj, Albulena Haxhiu, Dardan Sejdiu, Fikrim Damka dhe Slavko Simiq, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pastaj, kryetari vazhdoi procedimin e pikave të rendit të ditës si në vijim:

**1. Votimi i rekomandimeve nga interpelanca e kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Ramush Haradinaj, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje lidhur me vdekjen e dhunshme të aktivistit të Lëvizjes Vetëvendosje, Astrit Dehari**

Kryetari e hodhi në votim mocionin e propozuar nga GP i Lëvizjes Vetëvendosje.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 31,  
Kundër -----45,  
Abstenime ----- 7.

Kuvendi nuk e miratoi mocionin e propozuar nga GP i Lëvizjes Vetëvendosje.

## **2. Votimi në parim i Projekt-Rregullores së Kuvendit**

Kryetari e hodhi në votimin, në parim, Projekt-Rregulloren e Kuvendit.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 88,  
Kundër ----- 8,  
Abstenime ----- 2.

Kuvendi mori këtë:

### **V E N D I M**

1. Miratohet në parim Projekt-Rregullorja e Kuvendit.

2. Ngarkohen Komisioni FunkSIONAL dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projekt-rregulloren dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

## **3. Votimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes ndërkombëtare në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës (MASHT) dhe Stitching Spark-ut të Holandës (SPARK) mbi mbështetjen e Kolegjit Ndërkombëtar të Biznesit Mitrovica**

Kryetari i njoftoi deputetët se diskutimet për këtë projektligj kanë përfunduar në seancën plenare të mbajtur më 16 mars 2018, por në mungesë të kuorumit për vendimmarrje, votimi është shtyrë.

Kryetari e hodhi në votim Projektligjin për ratifikimin e kësaj marrëveshjeje.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 66,  
Kundër ----- 25,  
Abstenime ----- 12.

Kuvendi mori këtë:

## V E N D I M

Nuk miratohet Projektligji nr. 06/L-045 për ratifikimin e marrëveshjes ndërkombëtare në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës (MASHT) dhe Stitching Spark-ut të Holandës (SPARK) mbi mbështetjen e Kolegjit Ndërkombëtar të Biznesit Mitrovica.

### **4. Votimi i Projektligjit për ratifikimin e marrëveshjes për themelimin e Shkollës Rajonale të Administratës Publike (ReSPA)**

Kryetari i njoftoi deputetët se diskutimet për këtë projektligj kanë përfunduar në seancën plenare të mbajtur më 16 mars 2018, por në mungesë të kuorumit për vendimmarrje, votimi është shtyrë.

Kryetari e hodhi në votim Projektligjin për ratifikimin e marrëveshjes për themelimin e Shkollës Rajonale të Administratës Publike (ReSPA).

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 57,  
Kundër ----- 27,  
Abstenime ----- 16.

Kuvendi mori këtë:

## V E N D I M

Nuk miratohet Projektligji nr. 06/L-044 për ratifikimin e marrëveshjes për themelimin e Shkollës Rajonale të Administratës Publike (ReSPA).

### **5. Votimi i Projektligjit për ratifikimin e marrëveshjes për hua ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, për projektin e autostradës Kijevë-Zahaq**

Kryetari i njoftoi deputetët se diskutimet për këtë projektligj kanë përfunduar në seancën plenare të mbajtur më 23 mars 2018, por në mungesë të kuorumit për vendimmarrje, votimi është shtyrë.

Kryetari e hodhi në votim Projektligjin për ratifikimin e marrëveshjes për hua ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për projektin e autostradës Kijevë-Zahaq.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 88,  
Kundër ----- 8,  
Abstenime ----- 11.

Kuvendi mori këtë:

## V E N D I M

Miratohet Ligji nr. 06/L-063 për ratifikimin e marrëveshjes për hua ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për projektin e autostradës Kijevë-Zahaq.

### **6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 06/L-004 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-094 për Presidentin e Republikës së Kosovës**

Kryetari i njoftoi deputetët se komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij.

Kryetarja e Komisionit FunkSIONAL për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsion, Albulena Haxhiu, e paraqiti raportin e komisionit dhe rekomandimin për miratimin e këtij projektligji.

Kryetari i njoftoi deputetë se në këtë projektligj nuk është propozuar asnjë amendament.

Pastaj, kryetari e hodhi në votim Projektligjin nr. 06/L-004 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-094 për Presidentin e Republikës së Kosovës.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 41,  
Kundër ----- 30,  
Abstenime ----- 7.

Kuvendi mori këtë:

## V E N D I M

Miratohet Ligji nr. 06/L-004 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-094 për Presidentin e Republikës së Kosovës.

### **7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 06/L-013 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-072 për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 04/L-214**

Kryetari i njoftoi deputetët se komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij.

Deputeti Fatmir Xhelili, në emër të Komisionit FunkSIONAL për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, e paraqiti raportin e komisionit dhe rekomandimin për miratimin e këtij projektligji.

Në këtë projektligj ishin propozuar 7 amendamente, një amendament nga Komisioni Funkcional dhe 6 amendamente nga Grupi Parlamentar i Listës serbe, pa përkrahjen e Komisionit Funkcional.

Kryetari i hodhi një nga një në votim amendamentet e propozuara.

Kuvendi e miratoi amendamentin numër 1 të propozuar nga Komisioni Funkcional, ndërsa nuk i miratoi amendamentet me numër I, II, III, IV, V dhe VI të propozuara nga Grupi Parlamentar i Listës serbe, pa përkrahjen e Komisionit Funkcional.

Më pas kryetari e hodhi në votim tekstin e projektligjit me amendamentin e miratuar

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 70,  
Kundër ----- 8,  
Abstenime ----- 1.

Kuvendi mori këtë:

#### V E N D I M

Miratohet Ligji nr. 06/L-013 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-072 për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-214.

### **8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 06/L-014 për infrastrukturën kritike**

Kryetari i njoftoi deputetët se komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij.

Deputeti Fatmir Xhelili, në emër të Komisionit Funkcional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, e paraqiti raportin e komisionit dhe rekomandimin për miratimin e këtij projektligji.

Në këtë projektligj ishin propozuar 21 amendamente nga Komisioni Funkcional.

Kryetari i hodhi përnjëherë në votim amendamentet nga 1 deri 21 të Komisionit Funkcional

Kuvendi me shumicë votash i miratoi këto amendamente.

Pastaj, kryetari e hodhi në votim tekstin e projektligjit me amendamentet e miratuara.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 70,  
Kundër ----- 8,  
Abstenime ----- 1.

Kuvendi mori këtë:

## V E N D I M

Miratohet Ligji nr. 06/L-014 për infrastrukturën kritike.

### **9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 06/L-015 mbi masat doganore për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale**

Kryetari i njoftoi deputetët se komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij.

Kryetari i Komisionit FunkSIONAL për Buxhet dhe Financa, Lumir Abdixhiku, e paraqiti raportin e komisionit dhe rekomandimin për miratimin e këtij projektligji.

Në këtë projektligj ishin propozuar 12 amendamente nga Komisioni FunkSIONAL.

Kryetari i hodhi përnjëherë në votim amendamentet nga 1 deri 12 të Komisionit FunkSIONAL.

Kuvendi me shumicë votash i miratoi këto amendamente.

Pastaj, kryetari e hodhi në votim tekstin e projektligjit me amendamentet e miratuara.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 73,  
Kundër ----- 8,  
Abstenime ----- 1.

Kuvendi mori këtë:

## V E N D I M

Miratohet Ligji nr 06/L-015 për masat doganore për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale.

### **10. Votimi i raportit të performansës së ndërmarrjeve publike për vitet 2015 dhe 2016**

Kryetari i njoftoi deputetë se diskutimet për këtë raport kanë përfunduar në seancën plenare të mbajtur më 23 mars 2018, por për mungesë të kuorumit, nuk është proceduar për votim.

Pastaj, kryetari e hodhi në votim raportin e performansës së ndërmarrjeve publike për vitet 2015 dhe 2016.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 45,  
Kundër ----- 42,  
Abstenime ----- 2.

Kuvendi mori këtë:



## V E N D I M

Miratohet raporti i performansës së ndërmarrjeve publike për vitet 2015 dhe 2016.

### **13. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 06/L-023 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-115 dhe me Ligjin nr. 05/L-080.**

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni FunkSIONAL për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij.

Kryetari i Komisionit FunkSIONAL për Buxhet dhe Financa, Lumir Abdixhiku, e paraqiti raportin e komisionit dhe rekomandimin për miratimin e këtij projektligji.

Në këtë projektligj ishin propozuar 30 amendamente, 20 amendamente nga Komisioni FunkSIONAL dhe 10 amendamente nga Grupi Parlamentar i Listës serbe, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL.

Kryetari i hodhi përnjëherë në votim amendamentet nga 1 deri 18, të propozuara nga Komisioni FunkSIONAL.

Kuvendi me shumicë votash i miratoi amendamentet nga 1 deri 18 të Komisionit FunkSIONAL.

Më pas, kryetari i hodhi ndaras në votim amendamentet 19 dhe 20, pasi që kishte nga dy propozime për këto amendamente. Kuvendi me shumicë votash i miratoi amendamentet 19 dhe 20 të propozuara nga Komisioni FunkSIONAL.

Në vazhdim, kryetari i hodhi në votim përnjëherë amendamentet nga 21 deri 30 të propozuara nga Grupi Parlamentar i Listës serbe, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL.

Kuvendi nuk i miratoi amendamentet nga 21 deri 30 të propozuara nga Grupi Parlamentar i Listës serbe, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL.

Pastaj, kryetari e hodhi në votim tekstin e projektligjit me amendamentet e miratuara.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 62,  
Kundër ----- 22,  
Abstenime ----- 5.

Kuvendi mori këtë:

## V E N D I M

Miratohet Ligji nr. 06/L-023 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-115 dhe me Ligjin nr. 05/L-080.

#### **14. Emërimi i dy (2) anëtarëve të Komisionit për Verifikim dhe Vendorsje të Pronave dhe 12. emërimi i një anëtari të Komisionit për Kërkesa Pronësore**

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni Funkcional për Legjislacion i ka rekomanduar Kuvendit emërimin e dy anëtarëve në Komisionin për Verifikim dhe Vendorsje të Pronave, prej katër kandidatëve të propozuar për këtë komision si dhe emërimin e një anëtari të Komisionit për kërkesa pronësore prej dy kandidatëve të propozuar.

Kryetari propozoi që votimi i fshehtë të bëhet përnjëherë me kandidatët për Komisionin për Verifikimin dhe Vendorsje të Pronave dhe me kandidatët për Komisionin për Kërkesa Pronësore.

Kuvendi e miratoi propozimin e kryetarit.

Kryetarja e Komisionit Funkcional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsion, Albulena Haxhiu, i paraqiti dhe i arsyetoi raportet e komisionit.

Kryetari kërkoi nga grupet parlamentare që ta propozojnë nga një anëtar në Komisionin votues, për të zhvilluar procedurat e votimit të fshehtë.

Me propozimin e grupeve parlamentare, Kuvendi e zgjodhi Komisionin votues në këtë përbërje:

Haxhi Avdyli, GP LDK,  
Luljeta Gutaj-Veselaj, GP PDK,  
Arbër Rexhaj, GP LVV,  
Shqipe Pantina, GP Deputetët e Pavarur,  
Rasim Selmanaj, GP AAK,  
Zoran Mojsilović, GP Lista serbe,  
Albulena Balaj-Halimaj, GP Nisma dhe  
Danush Ademi, GP 6+.

Kryetari i ftoi anëtarët e Komisionit votues që të fillojnë procedurat e votimit të fshehtë për përzgjedhjen e dy (2) anëtarëve të Komisionin për Verifikim dhe Vendorsje të Pronave dhe përzgjedhjen e një (1) anëtari të Komisionit për Kërkesa Pronësore, si dhe i ftoi deputetët një nga një që të votojnë.

Pas zhvillimit të procedurës së votimit të fshehtë, në emër të Komisionit votues rezultatin e votimit për emërimin e dy anëtarëve të Komisionit për Verifikim dhe Vendosije të Pronave e paraqiti deputetja Luljeta Veselaj-Gutaj.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

- Në votim kanë marrë pjesë 104 deputetë,
- Të pavlefshme janë 11 fletëvotime.

Votat e fituara për kandidatët e propozuar ishin si në vijim:

1. Betim Shala i ka fituar 8 vota;
2. Sylejman Nuredini i ka fituar 7 vota;
3. Avdullah Aliu i ka fituar 30 vota dhe
4. Shpëtim Sadiku i ka fituar 59 vota.

Kryetari konstatoi: Në bazë të rezultateve të votimit, Shpëtim Sadiku, me 59 vota, emërohet anëtar i Komisionit për Verifikim dhe Vendosije të Pronave, me mandat 3-vjeçar, ndërsa dy kandidatët të cilët kanë marrë numër më të madh të votave, Avdullah Aliu me 30 vota dhe Betim Shala me 8 vota, shkojnë në rundin e dytë të votimit.

Në vazhdim, në emër të Komisionit votues rezultatin e votimit për emërimin e një (1) anëtari të Komisionit për Kërkesa Pronësore e paraqiti deputeti Haxhi Avdyli.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

- Në votim kanë marrë pjesë 105 deputetë;
- Të pavlefshme janë 13 fletëvotime;

Votat e fituara për kandidatët e propozuar janë, si në vijim:

1. Rrustem Qehaja i ka fituar 26 vota;
2. Lule Bilalli-Imeri i ka fituar 66 vota.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me votim të fshehtë mori këtë:

## V E N D I M

Znj. Lule Bilalli-Imeri emërohet anëtare e Komisionit për Kërkesa Pronësore, me mandat trevjeçar (3).

Kryesuesi e dha një pauzë deri në orën 14:30.

\* \* \*

Pas pauzës, kryesuesi e ftoi Komisionin votues të vazhdojë rundin e dytë të votimit për emërimin e një anëtari të Komisionit për Verifikim dhe Vendosije të Pronave dhe i ftoi deputetët një nga një që të votojnë.

Pas zhvillimit të procedurës së votimit të fshehtë, në emër të Komisionit votues rezultatin e votimit për emërimin e një anëtari të Komisionit për Verifikim dhe Vendosije të Pronave e paraqiti deputeti Haxhi Avdyli.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

- Në votim kanë marrë pjesë 84 deputetë,
- Të pavlefshme janë 15 fletëvotime,

Votat e fituara për kandidatët e propozuar ishin si në vijim:

1. Avdullah Aliu i ka fituar 54 vota,
2. Betim Shala i ka fituar 15 vota.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me votim të fshehtë mori këtë:

#### V E N D I M

Z. Avdullah Aliu, emërohet anëtar i Komisionit për Verifikim dhe Vendosije të Pronave, me mandat trevjeçar (3).

Kryesuesi i mbylli punimet e seancës plenare më 30 mars 2018, në orën 15:30 minuta.

Kryetari i Kuvendit:

Kadri VESELI

*Procesverbalin e hartoi:*

*Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale*